



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA SHTETËRORE
PËR SHPRONËSIMIN**

Nr. 62/3 Prot
Tiranë, më 18.01.2023

BASHKIA SHKODËR

Nr. 1213 Prot
Shkodër, më 26.1.2023

AKT- MARRËVESHJE

E lidhur sot, më datë 18.01.2023, ndërmjet palëve:

- Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin (më poshtë A.SH.SH) në cilësinë e *Autoritetit Përgjegjës për zhvillimin e procedurës së shpronësimit*, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, **Znj. Egra Ibrahim**,
- dhe
- Bashkisë Shkodër në cilësinë e *Subjektit Kërkues*, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, **Z. Bardh Spahia**,

Baza ligjore: Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, Vendimi nr. 138, datë 23.03.2000, e Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, Vendimi nr. 89, datë 03.02.2016, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, Vendimi nr. 395, datë 13.5.2020, i Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin”, kërkesa për shpronësim nr. 18061 prot., datë 02.12.2022, protokolluar në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin me nr. 857 prot., datë 07.12.2022, të Bashkisë Shkodër, në cilësinë e subjektit kërkues, si dhe Urdhrin nr. 180, datë 09.12.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH.

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i marrëveshjes është të përcaktojë angazhimin e ndërsjellë të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, si autoritet përgjegjës dhe Bashkisë Shkodër, si subjekti kërkues, për marrjen e masave dhe kryerjen e procedurave për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrugës Shëngjin - Baks Rrjoll – Velipojë Loti 1, Faza 1”.

Neni 2

Objekti i marrëveshjes

Objekti i kësaj marrëveshje është realizimi i projekteve dhe të investimeve, që paraqesin interes ose shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji,

të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut, bazuar në pikën “c”, të nenit 8, të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private, për interes publik”, i ndryshuar.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrimet e A.SH.SH

1. Brenda 10 ditëve nga dita e lidhjes së kësaj marrëveshje, A.SH.SH. duhet të përmbushë procedurat e njoftimit të Bashkisë Shkodër dhe të secilit pronar apo bashkëpronar të pasurive pronë private, që kërkohen të shpronësohen ose zhvlerësohen; si dhe personave të tretë, lidhur me kompensimin e tyre në bazë të nenit 14, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar; si dhe në zbatim të pikës 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 127, datë 23.3.2000 “Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik;
2. Në të njëjtën kohë A.SH.SH duhet të realizojë publikimin e kërkesës për shpronësim për interes publik, në Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe në faqen e internetit të A.SH.SH-së;
3. Brenda afatit të publikimit, A.SH.SH. ka për detyrë të njihet me pretendimet e pronarëve, kur ka të tilla, të shoqëruara me dokumentat përkatës;
4. Brenda 15 ditëve nga data e marrjes së përgjigjes nga të njoftuarit dhe jo më përpara se 1 (një) muaj nga data e fundit e afatit të publikimit të kërkesës për shpronësim për interes publik, në rastet kur të njoftuarit kanë pranuar kushtet mes palëve, A.SH.SH. kryen me të njoftuarit veprimet për kalimin e pronësisë në favor të shtetit, kundrejt shpërblimit apo pagesës së masës së kompensimit për zhvlerësimin e pasurive pronë private;
5. A.SH.SH, në përfundimin e procedurave paraprake të shpronësimit, i paraqet ministrit përgjegjës për zhvillimin urban propozimin për shpronësimin, të shoqëruar me dokumentacion, sipas përcaktimeve në pikën 1, neni 20, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 **“Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar;**
6. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 ditëve nga data e miratimit me Vendim të Këshillit të Ministrave, të shpronësimit, për interes publik, të pronarëve të pasurive pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrugës Shëngjin-Baks Rrjoll – Velipojë Loti 1, Faza 1”, do të kryejë veprimet përkatëse ligjore, për kalimin e pronësisë nga pronarët, në favor të Bashkisë Shkodër.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë Shkodër

1. Bashkia Shkodër, në cilësinë e subjektit kërkues përgatit dosjen e shpronësimit dhe aplikon pranë A.SH.SH si autoritet përgjegjës për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrugës Shëngjin-Baks Rrjoll – Velipojë Loti 1, Faza 1”;
2. Bashkia Shkodër, do të ofrojë mbështetje, do të asistojë dhe do të koordinojë veprimet me A.SH.SH, me qëllim përmbushjen e detyrimeve të kësaj marrëveshje;
3. Bashkia Shkodër, duhet të fillojë dhe të përfundojë punimet për projektin dhe investimin, për realizimin e qëllimit të shpronësimit, sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore;
4. Bashkia Shkodër, duhet të përdorë pasuritë pronë private të shpronësuara në përputhje me destinacionin dhe qëllimin e shpronësimit;
5. Në rast se shpronësimi deklarohet i pavlefshëm, Bashkia Shkodër detyrohet të paguajë shpërblimin e dëmeve të shkaktuara ndaj pronarëve të ligjshëm;
6. Bashkia Shkodër, duhet të informojë periodikisht ASHSH, mbi situacionin e realizimit të likuidimit të pronarëve të shpronësuar dhe në rast të mos likuidimit të tyre duhet të informojë ASHSH për shkakun e moskryerjes së këtij procesi rast pas rasti;

7. Vlera e shpenzimeve të procedurës së shpronësimit do të mbulohet nga Buxheti i Shtetit, Llogaria “Fondi i Shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.
8. Bashkia Shkodër, do të ofrojë mbështetje dhe do të asistojë A.SH.SH, me qëllim përmbushjen e detyrimeve të ndërsjellta të kësaj marrëveshje.
9. Bashkia Shkodër, përcjell dokumentacionin për likuidim, zyrtarisht pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, për kryerjen e likuidimit të pronarëve sipas përcaktimeve në V.K.M.

Neni 5

Vlefshmëria dhe zbatimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga palët, dhe mbetet në fuqi përgjatë gjithë periudhës së nevojshme e deri në momentin e përmbushjes nga palët të detyrimeve respektive të përcaktuara në përmbajtjen e saj, dhe legjislacionin referues.

Neni 6

Dispozita të fundit

Palët bien dakord të përcaktojnë një/disa përfaqësues si pikë kontakti për secilën palë me qëllim bashkërendimin e punës në praktikë. Këta përfaqësues do të kenë kontakte direkte me institucionet respektive.

Pikat e kontaktit duhet të mbajnë të informuar në çdo kohë titullarin e palës përkatëse mbi ecurinë e zbatimit të marrëveshjes.

Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe:

- dy kopje për Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin;
- dy kopje për Bashkinë Shkodër;


AUTORITETI PËRGJEGJËS

**AGJENCIA SHTETËRORE
PËR SHPRONËSIMIN**

PËRFAQËSUESI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Egra Ibrahim



SUBJEKTI KËRKUES

BASHKIA SHKODËR

PËRFAQËSUESI

KRYETAR I BASHKISË

